



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Data

30-07-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:006804
Datë: 08.05.2018
Numri i dokumentit: 00036847

P.nr.367/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.457-3/18 të datës 05.03.2018, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.457-3/18 të datës 05.03.2018, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 08.05.2018 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.457-3/18 të datës 05.03.2018, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj rr. [REDACTED], me nr. personal

██████████ i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion muzikant, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Me datën 08.01.2018, rreth orës 12:37, në rrugën "Rexhep Selimi", përballë lokalit "Liridoni", afër ëmbëltores "Sulltan", duke e drejtuar automjetin e tipit "Audi A3", ngjyrë e hirit metalike, me targa të regjistrimit ██████████ nga pakujdesia ka vënë në rrezik jetën e njerëzve në atë mënyrë që duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 par. 1 të Ligjit mbi Trafikun Publik, nuk i kushton kujdes të posaçëm pjesëmarrësve të tjerë në rrugë ku gjatë lëvizjes ka shfrytëzuar pjesërisht edhe trotuarin, ku për pasojë me rrotën e pasme të anës së djathtë e godet këmbën e djathtë të këmbësorës- të dëmtuarës ██████████, e cila ishte duke lëvizur në trotuar dhe nga ky aksident pëson ndrydhje të regjionit të shputës së këmbës së djathtë të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

-me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së:

GJYKON

Të akuzuarin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1(një) ditë burg.

Te dëmtuarën, ██████████ me vendbanim në fshatin ██████████ Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzon ne kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60.88 € (gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.457-3/18 të datës 05.03.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.457-3/18 të datës 05.03.2018, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështirim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: konstatimi i ekspertit mjeko ligjor Dr. [REDAKTUAR] e datës 28.02.2018, konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit rrugor inxh. kom. [REDAKTUAR] e datës 25.02.2018, skica dhe fotografitë e vendit të ngjarjes-aksidentit të komunikacionit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 60.88 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.367/18, me datë 08.05.2018

Zyrtarja ligjore

Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale

Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimt të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.